



Republika e Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - MUNICIPALITY OF VUSHTRRI
01 Nr./ Br _____ 16/20
Nr./ Iq./ Br. st _____ -01-
Data/ Datum _____ 30.01.2020
VEPISHI DREJTORIA E ZYRËS



Kuvendi i Komunës - Vushtrri


Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë, duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 1, pika “d” të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 12 të Statutit të Komunës, nenin 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR. 04/2018 për Transparencë në Komuna në lidhje me nenin 18 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, si dhe nenin 2 të Rregullores për Transparencë 01Nr.99/13, dt. 25.4.2013, në mbledhjen e mbajtur më **30 janar 2020**, mori këtë:

VENDIM
PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë.
2. Diskutimi publik fillon nga data 31 janar 2020 dhe zgjat deri më 2 mars 2020.
3. Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.
4. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike që si hartues i draft-rregullores në fjalë, të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet drejtoria e sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t’ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin mars 2020.
5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit





Republika e Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E VUSHTRISE
01 Nr. / Br. <u>17/20</u>
Nr. i fq. / Br. sh. <u>-01-</u>
Data / Data <u>30.01.2020</u>
VESHITUR - SHKUTUR




Kuvendi i Komunës - Vushtrri


Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, pas shqyrtimit të Draft-Planit të Integritetit për vitet 2020-2022 i Komunës së Vushtrrisë, duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 1, pika "d" të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 12 të Statutit të Komunës, nenin 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR. 04/2018 për Transparencë në Komuna në lidhje me nenin 18 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, si dhe nenin 2 të Rregullores për Transparencë 01Nr.99/13, dt. 25.4.2013, në mbledhjen e mbajtur më **30 janar 2020**, mori këtë:

VENDIM
PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft- Plani i Integritetit për vitet 2020-2022 i Komunës së Vushtrrisë.
2. Diskutimi publik fillon nga data 31 janar 2020 dhe zgjat deri më 2 mars 2020.
3. Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerri masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.
4. Obligohet Grupi Punuese për Zhvillimin e Planit të Integritetit që si hartues i këtij draft-dokumenti, të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet grupi i sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të detyrës të draft-rregullores në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin mars 2020.
5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu


Kryesues i Kuvendit





Republika e Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVES	QYTETI I VUSHTRISË
KOMUNA E VUSHTRISË	OPSTINA VUSHTRISË
01 Nr./ Br	18/20
Nr. i fq./ Br. st	-01-
Data/ Datum	30.01.2020
VUSHTRISË	



Kuvendi i Komunës - Vushtri

Kuvendi i Komunës së Vushtrisë, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për Ndarjen e Bursave për Studentë dhe Shpërblimeve për Nxënës të Komunës së Vushtrisë, duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 1, pika "d" të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 12 të Statutit të Komunës, nenin 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR. 04/2018 për Transparencë në Komuna në lidhje me nenin 18 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, si dhe nenin 2 të Rregullores për Transparencë 01Nr.99/13, dt. 25.4.2013, në mbledhjen e mbajtur më **30 janar 2020**, mori këtë:

VENDIM PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Ndarjen e Bursave për Studentë dhe Shpërblimeve për Nxënës të Komunës së Vushtrisë.
2. Diskutimi publik fillon nga data 31 janar 2020 dhe zgjat deri më 2 mars 2020.
3. Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.
4. Obligohet Drejtoria e Arsimit që si hartues i draft-rregullores në fjalë, të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet drejtoria e sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin mars 2020.
5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës

01 Nr. / Br	79/20
Nr. i fq. / Br. sh	-09-
Data / Datum	30.07.2020




Kuvendi i Komunës - Vushtrri

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, pas shqyrtimit të Draft-Kodit të Etikës të Komunës së Vushtrrisë, duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 1, pika “d” të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 12 të Statutit të Komunës, nenin 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR. 04/2018 për Transparencë në Komuna në lidhje me nenin 18 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, si dhe nenin 2 të Rregullores për Transparencë 01Nr.99/13, dt. 25.4.2013, në mbledhjen e mbajtur më **30 janar 2020**, mori këtë:

**VENDIM
PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK**

1. Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft- Kodi i Etikës i Komunës së Vushtrrisë.
2. Diskutimi publik fillon nga data 31 janar 2020 dhe zgjat deri më 2 mars 2020.
3. Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.
4. Obligohet komisioni komunale që si hartues i këtij draft-dokumenti, të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet komisioni i sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t’ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin mars 2020.
5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu


Kryesues i Kuvendit



01 Nr./Br	20/20
Nr. llog./llog. nr.	-01-
Data/ Data	30.01.2020



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri


Në bazë të nenit 51, paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 54 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe nenit 5, paragrafi 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) NR.02/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.03/2014 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **30 janar 2020**, mori këtë:

VENDIM


PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT ME NR.23/18 I DATËS 25.01.2018

1. Me këtë vendim bëhet ndryshimi dhe plotësimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr.01-23/18 i datës 25.1.2018, lidhur me emërimin e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), ashtu që në vend të znj. Rrezarta Krasniqi, nga radhët Lidhjes Demokratike (LDK), emërohet znj. Arta Imeri, nga i njëjti subjekt politik, ndërsa në vend të znj. Fjolla Ujkani emërohet znj. Gresa Muli anëtare e Komitetit për Politikë dhe Financa nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e Kuvendit.
3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit





Republika e Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E VUSHTRISË
01 Nr. / Br <u>21/20</u>
Nr. i fq. / Br. sh <u>-01-</u>
Data / Datimi <u>30.01.2020</u>



Kuvendi i Komunës-Vushtrri


Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika "d" të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 41, paragrafi 2, pika "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më **30 janar 2020**, mori këtë:


VENDIM

PËR APROVIMIN E PLANI KOMUNAL PËR RIINTEGRIMIN E QËNDRUESHËM TE PERSONAVE TË RIATDHESUAR 2019 – 2022

1. Me këtë vendim aprovohet Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar i Komunës së Vushtrrisë 2019-2021.
2. Qëllimi i aprovimit të këtij plani është konsolidimi i infrastrukturës juridike me qëllim të arritjes së objektivave për riintegrimin të qëndrueshëm të personave të riatdhesuara në Komunën e Vushtrrisë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar i Komunës së Vushtrrisë 2019-2021.
5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu


Kryesues i Kuvendit





REPUBLICA E KOSOVES
KOMUNA E VUSHTRISE

01 Nr. / Br 22/20

Nr. i fq. / Br. sh -01-

Data / Datum 30.01.2020

VESHITIMI - MË ÇERN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri


Në bazë të nenit 12, paragrafi 2 pika "d" të Ligjit nr.03/L-40/2008 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 4, 5, 6 dhe 21 pika 1.1 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, si dhe nenit 41, paragrafi 2 pika "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më **30 janar 2020**, miratoi këtë:


VENDIM


PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS PA KOMPENSIM, MINISTRISË TË PUNËVE TË BRENDSHME-DREJTORIA RAJONALE E POLICINË MITROVICË

1. Me këtë vendim jepet në shfrytëzim pakompensim parcela kadastrale P-70202053-00478-0, ZK-Prelluzhë, pronë e Komunës së Vushtrrisë, në sipërfaqe prej 301 m².
2. Paluajtshmëria e cekur në nenin 1 të këtij vendimi i jepet në shfrytëzimin pa kompensim, në afat prej 99 vitesh, Ministrisë të Punëve të Brendshme – Drejtorisë Rajonale të Policisë në Mitrovicë, për ndërtimin e objektit për nevoja të nënstacionit policor në fshatin Prelluzhë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është certifikata e pronës dhe kopja e planit.
5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu


Kryesues i Kuvendit





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 10.5 pika "b", nenin 13.1, nenit 14 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit mbi tokën bujqësore (Nr.02/L-26), nenit 6.3 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore (Nr.41/2006 në bazë të nenit 12.2 pika (d) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Nr.03/L-040), nenit 41.2 pika "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **30 janar 2020**, mori këtë:

VENDIM
PËR LEJIMIN E NDËRRIMIT TË DESTINIMIT TË TOKËS BUJQËSORE NË TOKË NDËRTIMORE

1. Me këtë vendim lejohej ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore në parcelën kadastrale: nr.P-70202030-00568-0, me kulturë arë e klasës së 5 (pestë), në sipërfaqe prej 550 m² nga sipërfaqja totale 7952m², Zona Kadastrale Druvar, pronë e Gëzim (Rifat) Salihu me vendbanim në fshatin Druar, Komuna Vushtrri.
2. Qëllimi i lejimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në parcelën kadastrale të cekur si në pikën 1 të këtij vendimi është ndërtimi i objektit me destinim Fermë për majmërin e viqave.
3. Lejen ndërtimore dhe kushtet për rregullimin e hapësirë për ndërtimin e objektit nga pika 2 e këtij Vendimi do ta lëshojë dhe përcaktojë konform dispozitave ligjore Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit pas pagesës së tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore.
4. Obligohet pronari i parcelës nga pika 1 e këtij Vendimi që të bëjë pagesën e tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore sipas nenit 14.2 nën "b" të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore Nr.41/2006, përmes Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.
6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu


Kryesues i Kuvendit

